

Ky dokument përfshin informacionin kryesor për investitorin mbi këtë SIK. Dokumenti nuk është material marketingu. Dhënia e këtyre informacioneve kërkohej me ligj, për t'ju ndihmuar të kuptoni natyrën dhe risqet që shoqërojnë investimin në këtë fond. Ky dokument i vihet në dispozicion investitorëve pa pagesë. Ju këshillohet ta lexoni, në mënyrë që të informoheni përpara se të merrni vendimin për të investuar ose jo. Dokumenti i bën referencë informacionit të pasqyruar në Prospektin e Fondit. Kuotat/aksionet e SIK nuk janë depozita dhe nuk janë të siguruara nga skema e sigurimit të depozitave, investimi në SIK nuk është një investim i garantuar, SIK nuk bazohet në përkrahjen e ndonjë subjekti jashtë tij për garantimin e likuiditetit apo stabilitetin e vlerës neto të aseteve dhe risku i humbjes së principalit duhet të përballohet nga investitori.

Të dhënat identifikuese të SIK

Lloji: **Fond Investimi**
Emërtimi: **"ABI EIA"**
Shoqëria Administruese: **"ABI INVEST SH.A"**

Karakteristikat kryesore të produktit

Investimi në fond kryhet nëpërmjet blerjes së një numri kuotash për të cilat Fondi çdo ditë publikon një çmim. Ky çmim përlogaritet në bazë të vlerës së tregut të të gjitha aseteve në zotërim kundrejt numrit të përgjithshëm të kuotave në zotërim të klientëve në fond. Diferenca mes çmimit të ditës dhe atij të hyrjes në fond përbën kthimin nga investimi të klientit.

- Investitori ka të drejtë të kërkojë shlyerje të kuotave në zotërim të tij, të plotë apo të pjesshme, në çdo moment. Shoqëria administruese ka detyrim të realizojë shlyerjen brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja në dorëzim e një kërkesë të vlefshme për shlyerje (me përjashtim të rasteve kur shoqëria administruese ushtron të drejtën e pezullimit të shitjeve dhe shlyrjeve pas marrjes së miratimit nga AMF në zbatim të ligjit 56/2020 dt 30.04.2020). Kuotat tregtohen çdo ditë pune.
- SIK nuk mbështetet në një tregues referencë (benchmark)
- Të ardhurat të cilat lindin nga aktiviteti i Fondit nuk shpërndahen, por ri-investohen në Fond.

Objektivat dhe Politika e Investimit

Objektivi i investimit të Fondit është të maksimizojë përfitueshmërinë/kthimin për investitorët duke mbajtur në vëmendje gjithashtu të sigurojë likuiditet të mjaftueshëm. Portofoli i investimeve të Fondit "ABI EIA" përbëhet kryesisht nga Letra me Vlerë të Qeverisë Shqiptare dhe depozita me bankat e nivelit të dytë në monedhën LEKË.

Shuma minimale për të investuar në fond është 50,000 Lekë dhe shuma minimale për të shtuar investimin është 10,000 Lekë.

Kategoritë kryesore të instrumenteve financiare të lejuara që janë objekt i investimit

- Depozita me Banka apo Marrëveshje të Ri-blerjes dhe cash.
- Letra me vlerë të emetuara apo garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- Letra me vlerë të emetuara nga Institucione Shtetërore Vendore apo shoqëri tregtare.
- Kuota në fondet e tjera.

Kategoritë kryesore të aktiveve

- Në cilat lloje të letrave me vlerë të borxhit investon SIK;** Fondi investon kryesisht në Letra me vlerë të emetuara apo garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë (maksimumi deri 90% të aseteve) si dhe në tituj borxhi të Institucioneve Vendore Shtetërore dhe të shoqërive tregtare (maksimumi deri në 30% të aseteve).
- Informacion lidhur me pagesa të paracaktuara dhe faktorët që pritet të përcaktojnë performancën;** Ecuria e Fondit është e lidhur ngushtë dhe kryesisht me ecurinë e normave të interesit të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, duke qenë se është edhe kategoria e aseteve e cila zë peshën më të madhe në portofolin e Fondit. Gjithashtu, arkëtimet dhe pagesat mund të sjellin ndikim në performancë.
- Orientimi i përzgjedhjes së aktiveve;** Përzgjedhja e aseteve për investim orientohet kryesisht nga konsiderimi i faktorëve si: profili i riskut, kthimi i titullit si dhe respektimi i nevojave për likuiditet.
- Ndikimi i teknikave të mbrojtjes/arbitrazhit/levës financiare në performancën e SIK;** Përmbyshja e kërkesave të klientëve dalës nga Fondi (rastet kur vlerat janë të konsiderueshme dhe nuk mbyllen dot nga rezervat aktuale të cash dhe depozitave afatshkurta me bankat) mund të kryhet përmes: a) Shitjes së letrave nga portofoli dhe b) huamarrjes kryesisht përmes Marrëveshjeve të ri-blerjes. Huamarrja konsiderohet si alternativë optimale në zbutjen e impaktit negativ që ka te çmimi i kuotës alternativa e shitjes së letrave nga portofoli krahasuar me atë të huamarrjes. Kjo zbutje e impaktit negativ nëpërmjet huamarrjes ndihet më shumë në situatën kur Fondi disponon letra me vlerë në portofol, të cilat kanë datën e maturimit afër me datat e shlyerjeve. Në këtë rast zgjidhet alternativa e huamarrjes në vend të asaj të shitjes së sforcuar të letrës, shitje e cila mund të vijë me një çmim jo të favorshëm në atë moment për Fondin dhe me impakt negativ mbi çmimin e kuotës e rrjedhimisht mbi interesat e investitorëve në Fond.
- Deklaratë nëse kostot e transaksioneve të portofolit kanë ndikim material te performanca;** Vlerat që lidhen me kostot e transaksioneve të portofolit nuk kanë ndikim material mbi ecurinë e Fondit në tërësi dhe të çmimit të kuotës në veçanti.
- Periudha minimale e rekomanduar e mbajtjes së kuotave;** Rekomandohet që investitorët të qëndrojnë minimalisht për një periudhë 2 vjeçare në Fond.

Profili i riskut dhe përfitimi

Të dhënat historike nuk mund të përdoren si indikatorë të qëndrueshëm për të përcaktuar të ardhmen. Kategoria e treguar e riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës. Kategoria më e ulët nuk nënkupton mungesën e plotë të riskut. Përse SIK ndodhet në kategorinë specifike: Fondi "ABI EIA" mbart një profil risku të nivelit 2, i cili konsiderohet i ulët. Kjo kategori e përbërë përkufizohet kryesisht nga të dhëna historike e tipologjike të bazuara tek volatiliteti i Fondit, e për rrjedhojë, projeksioni i ardhshëm i profilin mund të ndryshojë. Megjithatë, duke qenë se ecuria e kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të Letrave me Vlerë të Qeverisë (të cilat në vetvete kanë luhatshmëri relativisht të ulët), përfshirë këtu edhe impaktin e po këtyre investimeve kryesisht afatgjata, parashikimet për të ardhmen janë gjithsesi për ndryshime të moderuara të profilin të riskut në fjalë. Gjithsesi, qëndrueshmëria e kategorisë së profilin të riskut nuk garantohet dhe mund të ndryshojë në të ardhmen. Megjithatë duke marrë në konsideratë kategoritë në të cilat Fondi investon, mund të garantohet luhatshmëri e ulët ndërmjet klasave të profilin të riskut.

Risk i ulët Risk i lartë
Fitime zakonisht të ulëta Fitime zakonisht të larta

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Paraqitje narrative e risqeve të rëndësishme për SIK

- **Risku i kredisë:** Nënkupton situatën kur një emetues i titujve të borxhit në portofolin e fondit ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese dhe si rrjedhojë nuk paguan detyrimet e tij në formën e kuponit apo principalit çka do të kishte një impakt negativ mbi vlerën e asetëve të Fondit. Edhe kur instrumentat e investimit zgjidhen me kujdesin dhe përgjegjshmërinë e duhur, është e pamundur që risku i kredisë të përjashtohet plotësisht.
- **Risku i likuiditetit** ka të bëjë me mungesën e tregtueshmërisë së një instrumenti financiar në portofolin e fondit, dhe pamundësisë për tu shitur ose blerë, shpejt dhe pa ndikuar cmimin e instrumentit në treg. Si rezultat shoqëria administruese mund të haste vështirësi në lidhje me detyrimin për të shlyer kuota për shkak të mungesës së likuiditetit në treg, dhe pamundësisë për të shitur instrumentat financiare në portofolin e fondit.
- **Risku i palës tjetër ose palës së lidhur** Kjo kategori e riskut përfaqëson mundësinë që shlyerja në një sistem transfertash nuk përmbushet si duhet nga kundërparta e cila mund të mos paguaë, ose mund të vonojë pagesën. Risku i shlyerjes lidhet me mos marrjen e shumës korresponduese pas përmbushjes së një transaksioni.
- **Risku operacional** është risku i humbjes nga procedura të brendshme të papërshtatshme dhe nga mosfunksionimi në lidhje me sistemet dhe stafin e shoqërisë administruese ose palës së lidhur e cila kryen disa funksione të deleguara për shoqërinë administruese, ose që rezulton nga ngjarje të jashtme dhe që përfshin risqe ligjore, risqe dokumentacioni dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregimit, shlyerjes dhe vlerësimit, të cilat zbatohen nga fondi; Vjen nga gabimet të sistemeve dhe njerëzore të personelit brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme (apo mos-ekzistenca e proceseve të përshtatshme) etj.

Komisionet dhe Tarifat që paguani përdoren për të shlyer kostot e administrimit të SIK, përfshirë kostot e marketimit dhe shpërndarjes së tij. Këto komisione ulin rritjen e mundshme të investimit Tuaj.


Tarifa e hyrjes në Fond	Nuk mban tarifë hyrjeje	Të njëhershme
Tarifa e daljes nga Fondi	Nuk mban tarifë daljeje	Të njëhershme
Tarifa e Administrimit	1.00% e VNA në terma vjetore	Të vazhdueshme
Tarifa e Depozitarit	0.15% e VNA në terma vjetore	Të vazhdueshme
Tarifa e AMF	0.05% e VNA në terma vjetore	Të vazhdueshme
Komisione për shit-blerjen e asetëve të Fondit	Sipas kushteve të punës të tregut ku kryhet transaksioni	Të vazhdueshme
Tarifa e Auditimit vjetor të Fondit	Sipas marrëveshjes me palëve	Të vazhdueshme

Në asnjë rast, shumat e kostove të listuara më sipër nuk mund të tejkalojnë maksimumin prej 1.50% të Vlerës Neto të Asetëve të Fondit. Shifrat bazohen në shpenzimet e fundit të vitit dhe se kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Në të nuk përfshihet tarifa e performancës, duke përjashtuar rastin e komisioneve dhe tarifave për hyrje dhe dalje të paguara nga SIK, kur blihen dhe shiten kuota/aksione të SIK.

Performanca e kaluar e Fondit

Performanca e shkuar shërben vetëm për qëllime informative dhe nuk përfaqëson premtim apo garanci për performancën e fondit në të ardhmen. Performanca e treguar në grafik është kthimi neto i fondit, pasi është zbritur tarifa e vazhdueshme vjetore. Performanca e shkuar është llogaritur në monedhën LEKË. Fondi ka nisur aktivitetin më 01.03.2021.

Nga themelimi deri më 31 Dhjetor 2021, Fondi ABI EIA ka realizuar një kthim të pa anualizuar prej 2.1%. Ky kthim shërben vetëm si indikator i performancës për ate periudhë që është përcaktuar.



Informacione Praktike

- Emri i depozitarit të fondit të investimit “ABI EIA” është Banka Credins SHA me seli në adresën Rruga Vaso Pasha nr 8, Tiranë, Shqipëri.
- Informacione të mëtejshme për SIK (prospekti,raportet & pasqyrat financiare) mund të sigurohen në adresën e internetit të shoqërisë: www.abinvest.al
- Informacione të tjera praktike si çmimet më të fundit të kuotave dhe Vlera Neto e Asetëve të Fondit publikohen në adresën e internetit të shoqërisë: www.abinvest.al
- Legjislacioni tatimor i vendit të origjinës të SIK mund të ketë ndikim te pozicioni tatimor personal i investitorit – Shtetas i huaj.
- Shoqëria administruese “ABI Invest” është përgjegjëse e vetme për çdo informacion/deklaratë të përfshirë në këtë dokument që është çorientues, i pasaktë ose në kundërshtim me pjesët përkatëse të prospektit SIK të sipërmarrjes.
- Ky SIK është licensuar më 29.12.2020 dhe rregullohet nga Ligji 56/2020 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”.
- Shoqëria administruese “ABI Invest” SHA është licencuar në Shqipëri dhe mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- Informacionet Kryesore për investitorin janë të sakta dhe të vlefshme në datën 07.01.2025.